



Udhëzues për themelimin e Qendrës për Orientim në Karrierë

“Ky udhëzues është produkt i projektit “Përfshirja e të rinjve në zhvillimin e arsimit profesional”, në kuadër të programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, mbikëqyrur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC dhe implementuar nga Organizata Jo-Qeveritare Iniciativa për Progres – INPO.

Përmbajtja është përgjegjësi e Organizatës INPO dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.”



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Organizata Jo-Qeveritare Iniciativa për Progres – INPO. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
QENDRA PËR ORIENTIM NË KARRIERË	5
RËNDËSIA E QENDRËS PËR ORIENTIM NË KARRIERË	6
SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA PËR ORIENTIM NË KARRIERË	7
AKTIVITETET INFORMUESE PËR PROMOVIM TË SHKOLLAVE TË MESME PROFESIONALE.....	9
THEMELIMI I QENDRAVE PËR ORIENTIM NË KARRIERË	10
MUNDËSITË POTENCIALE TË FINANCIMIT.....	11
INICIATIVA PËR PROGRES – INPO.....	13

HYRJE

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të shërbejë si bazë për komunat e Republikës së Kosovës për të filluar procedurat për themelimin e Qendrës për Orientim në Karrierë.

Përmes këtij udhëzuesi, komunat – gjegjësisht drejtoritë komunale të arsimit (DKA-të), mund të informohen me qëllimin, rëndësinë, aktivitetet, mënyrat e themelimit si dhe financimin e Qendrës për Orientim në Karrierë.

Udhëzuesi do t'iu drejtohet komunave që ato të marrin përsipër themelimin e Qendrave për Orientim në Karrierë, ku nëpërmjet kësaj nisme do t'u mundësonin të rinjve të kenë informata parësore mbi programet e studimeve që veçse ekzistojnë në shkollat e mesme të larta për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, për mundësitë në tregun e punës që kanë drejtimet e caktuara, dhe nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të kenë më të qartë orientimin e tyre në karrierë.

Një nga aktivitetet kryesore të Qendrës për Orientim në Karrierë është informimi, për t'iu ofruar të rinjve të dhëna për temat në vijim:

- Mundësitë për arsimim të mëtejshëm: programet e ndryshme të studimit dhe aftësimin profesional, shkollat e mesme të larta – profesionale, ofruesit e arsimit të lartë, ndihma financiare e disponueshme për studime,
- Informacionet për profesione, ku informacioni i tillë mund të fitohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si: vizita në ndërmarrje, prezantim i profesioneve në klasë, përshkrime të printuara të profesioneve, video rreth profesioneve e të tjera. Përshkrimi i profesioneve përfshin informacione sikurse: cila është natyra e punës, cilat janë detyrat kryesore (çfarë bëjnë njerëzit në punë), çfarë aftësish dhe karakteristikash të tjera janë të nevojshme për këtë profesion,
- Informacione rreth tregut të punës: vendet e lira të punës, profesionet që do të kërkohen në të ardhmen, aftësitë që do të kërkohen në të ardhmen etj.

QENDRA PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Koncepti mbi të cilin duhet të ndërtohet Qendra për Orientim në Karrierë përfshinë krijimin e parakushteve për lidhjen e shkollave të arsimit profesional me sektorin privat.

Orientimi në karrierë në vete përmban një sërë veprimesh të cilat ndihmojnë një të ri në procesin e përzgjedhjes së shkollimit, profesionin në të cilin ata do të orientojnë angazhimin e tyre dhe zhvillimin në drejtim të arritjes së synimeve profesionale. Duke i qëndruar afër këtij koncepti, mund të konstatohet se orientimi në karrierë përbën një nga elementet boshlore në dizajnimin e politikave shtetërore si në arsim ashtu edhe në punësim. Si koncept, orientimi në karrierë në vendet e BE-së është përkufizuar në vitin 2004 me anë të akteve dytësore juridike, gjegjësisht Rezolutës së BE-së për orientim në Karrierë¹.

Koncepti mbi të cilin duhet të ndërtohen Qendrat për Orientim në Karrierë përfshinë krijimin e parakushteve për lidhjen e shkollave të arsimit profesional me sektorin privat. Kjo lidhje shtrihet mbi mundësinë e përmirësimit të komunikimit me tregun e punës, gjetjes efektive të vendeve të punës, zhvillimin e marrëdhënieve në mes të punëdhënësve dhe punonjësve të nivelit të praktikës, rritjen e mundësive për karrierë si dhe krijimin e një mekanizmi të specializuar për këtë aspekt.

Qendra për Orientim në Karrierë duhet ta përmbush misionin e saj përmes ofrimit të informatave të plota dhe të besueshme për nxënësit e shkollave fillore rreth mundësisë së regjistrimit në shkolla të mesme profesionale, si dhe vendosjes së lidhjeve mes sektorit privat dhe punëkërkuesve/ nxënësve. Kjo lidhshmëri do të avancohet përmes krijimit të mundësive për praktikë profesionale dhe udhëzime për nxënës sa i përket mundësive të punësimit por edhe duke stimuluar vetëpunësimin tek nxënësit. Qendrat e tilla duhet të veprojnë mbi plane të veprimit të hartuara nga profesionist të fushës, të implementuar nga stafi i angazhuar brenda qendrës të specializuar në udhëzime në karrierë, praktikë profesionale si dhe zhvillim dhe përkrahje në vetëpunësim.

¹ Rezoluta e BE-se mbi Orientimin për Karrierën shih:

http://www.trainingvillage.gr/etv/Upload/Projects_Networks/Guidance/EU_Policy_Context/Council_Resolution_on_Guidance-EN.pdf, qasur me: 01.11.2016

RËNDËSIA E QENDRËS PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Qendra për Orientim në Karrierë do të krijonte parakushte për lidhjen e shkollave për arsim dhe aftësim profesional (SHAAP) me sektorin privat, u ofron nxënësve të SHAAP-së mundësitë për të fituar njohuri, aftësi dhe përvojën e duhur.

Në hulumtimin e realizuar nga INPO mbi përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e arsimit profesional, paraqitet rëndësia e shkollave profesionale si bosht i zhvillimit ekonomik. Në ndërkohë, kërkohet të ketë ngritje në numrin e nxënësve të regjistruar në këtë fushë. Tërheqja e nxënësve bëhet me kualitet përmes programeve atraktive dhe kushteve të mësimin. Lëndët dhe kushtet më të mira përbëjnë dy motivuesit kryesor të nxënësve për t'u regjistruar në shkolla të mesme profesionale, pasuar nga cilësia e mësimdhënësve dhe mundësitë për punësim.

Me qëllim të rritjes së numrit të nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme profesionale, dhe ngritjes së mundësive për punësim, kërkohet që nxënësve t'u ofrohen mundësi për orientim dhe këshillim në karrierë.

Në këtë funksion, krijimi i Qendrës për Orientim në Karrierë paraqitet si një nevojë e menjëhershme.

Krijimi i këtyre qendrave mbështetet mbi tre pika kryesore:

- secila komunë të krijoj qendrën për orientim në karrierë e cila do të krijonte lidhshmëri mes shkollave fillore dhe të mesme të ulëta me shkollat e mesme profesionale,
- Qendra do t'u ofrojë nxënësve të SHAAP-së mundësitë për të marrë njohuri, aftësi dhe përvojën e duhur për të identifikuar opsionet, për të shqyrtuar alternativat në tregun e punës dhe për të pasur sukses në shoqëri,
- Qendra për Orientim në Karrierë, mbi të gjitha do t'u mundësonte nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të marrin informacion të kompletuar mbi drejtimet, mundësitë dhe procesin mësimor në shkollat profesionale të nivelit të mesëm të lartë.

Përpos zhvillimit personal, qendra duke shfrytëzuar databazën e saj të nxënësve, shkollave dhe bizneseve, do të mundësoj shkëmbimin e informatave në lidhje me drejtimet dhe mundësitë e ofruara për nxënësit nga shkollat profesionale, kuadrin e kërkuara nga tregu, lidhjen e nxënësve me kompani të profilit të kërkuar dhe anasjelltas. Në funksion të ndërlidhjes mes nxënësve (studentëve) dhe bizneseve, Qendra do të mund të organizonte ngjarje të përbashkëta në mes nxënësve, shkollave dhe bizneseve.

Qendrat për Orientim në Karrierë u mundësojnë kompanive që në mënyrë më të lehtë dhe të shpejtë, të gjejnë praktikantë dhe punëtorë, pa pasur nevojë që të kalojnë nëpër procedura të cilat zakonisht marrin kohë dhe janë të kushtueshme për kompanitë. Ndërsa, nxënësit fillimisht do t'i orientonte drejt studimit në drejtime shumë atraktive që ofrohen nga shkollat e mesme profesionale, e pastaj do t'i lidhte edhe me tregun e punës.

SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Qendra për Orientim në Karrierë do t'u ndihmonte nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulta të zgjedhin rrugën e duhur profesionale në proces të zhvillimit të mëtejshëm në karrierën e tyre përmes informimit, edukimit, këshillimit dhe asistimit fillimisht në regjistrim në shkollë e pastaj edhe në punësim.

Orientimi për karrierën përfshin dhe referon aktivitete të ndryshme praktike. Orientimi për karrierë përfshin një sërë aktiviteteve nëpërmjet të cilave mund të ndihmohen për të marrë vendimet që përcaktojnë rrjedhën e zhvillimit profesional dhe arsimor të nxënësve. Aktivitetet kryesore të orientimit në karrierë shtrihen mbi tre baza: informim, mundësi për arsimim të mëtejshëm dhe informacione për profesione të caktuar.

Për të arritur një gjë të tillë, Qendra për Orientim në Karrierë parasheh ofrimin e shumë aktiviteteve, duke kontribuar kështu direkt në informimin e saktë dhe të drejtë si dhe orientimin e nxënësve në ndërmarrjen e hapave të mëtutjeshëm drejt zgjedhjes së drejtimit të duhur dhe regjistrimit në shkolla të mesme. Duke u bazuar edhe nga praktikatat e Qendrës për Orientim në Karrierë në Komunën e Prishtinës si dhe shteteve të rajonit, disa nga aktivitetet që do të mund të ofroheshin nga Qendrave për Orientim në Karrierë janë:

- Ofrimi i informatave rreth drejtimeve të ofruara nga shkollat e mesme të larta, me fokus në shkollat e mesme profesionale,
- Edukimi për karrierë duke i kushtuar rëndësi të veçantë ndërlidhjes së shkollimit dhe mundësive për punësim,
- Këshillim për karrierë duke u vënë theks profesioneve inovative dhe atyre me mundësi më të mëdha për punësim,
- Të shërbejë si urë lidhëse mes nxënësve, shkollave, institucioneve publike dhe kompanive private duke ofruar mundësi për realizimin e praktikës profesionale,
- Aranzhim dhe referim për vende të lira të punës.

Qendra në baza të rregullta do të mund të organizojë sesione informative me nxënës për të ndihmuar orientimin dhe avancimin në karrierë. Gjithashtu, Qendra mund të organizojë edhe kurse plotësuese profesionale për zhvillimin e të ashtuquajturave shkathtësi të buta për nxënësit, të cilat kurse do të jenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Duke shfrytëzuar data-bazën e kontakteve të kompanive me të cilat qendrat mund të arrijnë bashkëpunim, në bazë të informatave për kualifikimet e kërkuar nga kompanitë, qendra do të realizojë ndërlidhjen e nxënësve me kompani të profilit të tyre për t'u mundësuar nxënësve jo vetëm mirë-informim sa i përket zgjedhjes së drejtimit të mësimi, por edhe realizimin e praktikës profesionale.

Çfarë shërbime të udhëzimit dhe këshillimit mund të ofrojë Qendra për Orientim në Karrierë?

Shërbimet e udhëzimit dhe këshillimit të përfshira brenda këtyre kategorive përbëjnë:

- Këshillimin individual dhe grupor me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta rreth drejtimeve të shkollave të mesme të larta me fokus ato profesionale,
- Hartim i doracakëve ku do të përfshiheshin profilet e të gjitha shkollave të mesme profesionale të komunës specifike, si dhe drejtimet që ofrohen nga ato shkolla,
- Shërbime të gjetjes së punësimit (shpallje të vendeve të punës, panairë të karrierës),
- Informime publike përmes adresës elektronike, përmes webfaqes dhe rrjeteve sociale lidhur me përparësitë e regjistrimit në shkollat e mesme profesionale,
- Trajnime në fushën e të ashtuquajturave “njohuri të buta”, siç janë përgatitja e CV dhe letrave motivuese, përgatitja për intervistë për punë, qasja në tregun e punës, shkathtësi për prezantime dhe komunikim në baza të rregullta kohore,
- Organizimi i javës së informimit për studentët e ardhshëm në shkolla të mesme profesionale,
- Krijimi i një baze të të dhënave me frekuentues të veçuar bizneset,
- Një webfaqe me të dhëna për qendrën,
- Shërbime ndërlidhëse mes punëdhënësve në sektorin privat dhe publik,
- Ofrim i ndihmës për studentët për t'u informuar rreth mundësive për kryerjen e praktikës profesionale,

- Krijimi i një platforme online për informimin e nxënësve rreth mundësive për praktikat profesionale, bursat, trajnimet në vend dhe jashtë, kurset e gjuhëve të huaja, kurseve për kompjuterë, programeve, seminareve, konferencave etj.,
- Organizimi i debateve mes nxënësve potencial dhe atyre të diplomuar nga shkollat profesionale me qëllim të shkëmbimit të përvojave,
- Organizimi i sesioneve informuese edhe me prindërit apo kujdestarët e nxënësve potencial të shkollave të mesme profesionale, për të vënë në pah rëndësinë e shumëllojshmërinë së drejtimeve të ofruara,
- Organizimi i ngjarjeve dhe fushatave të ndryshme vetëdijesuese rreth rëndësisë së shkollave të mesme profesionale.

Qendra mund të ofrojë edhe shumë aktivitete tjera të ngjashme – kryesisht për informim të nxënësve, varësisht nga resurset financiare dhe njerëzore të Qendrës.

AKTIVITETET INFORMUESE PËR PROMOVIM TË SHKOLLAVE TË MESME PROFESIONALE

Aktualisht komunitat bëjnë pak për promovim të shkollave profesionale. Vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve nga INPO në kuadër të hulumtimit “Përfshirja e të rinjve në zhvillimin e arsimit profesional”, kanë deklaruar që kanë mësuar për arsimin profesional nga përfaqësuesit institucional. Në përgjithësi, promovimin e shkollave profesionale e kanë realizuar vetë shkollat duke përgatitur fletëpalosje për promovim të programeve përmes vizitave në shkolla.

Promovimi ka bërë që të rritet numri i të interesuarve për shkollat profesionale, edhe pse në vazhdimësi ka rënie të numrit të nxënësve. Gjithashtu, puna me media në promovim të shkollave profesionale nuk është në nivelin e duhur. Një tregues interesant është fakti së pjesa dërrmuese e të anketuarve deklarojnë që për arsimin profesional kanë mësuar nga anëtarët e familjes. Ky është një tregues shqetësues për faktin së mund të ndikoj në krijimin e perceptimeve të gabuara dhe të ndikojë në mosinteresim të nxënësve për shkollat profesionale.

Me qëllim që të ketë një promovim të drejtë dhe të ndikojë në shtim të interesimit për shkollat e mesme profesionale një rol shumë të rëndësishëm mund ta luaj Qendra për Orientim në Karrierë. Qendra mund të organizojë ngjarje të ndryshme, ku marrin pjesë bizneset dhe të diplomuarit e shkollave profesionale, me qëllim të promovimit të shkollave profesionale, komunikimit interaktiv në mes të dy palëve, rrjetëzimit dhe bashkëpunimit. Në këtë drejtim, përpos që do të rritet besueshmëria në shkollat profesionale, po ashtu do të mundësohet shpërndarja e informatave të sakta për to.

Për të përmbushur këtë duhet të ndërmerren disa veprime në bashkëpunim me shkollat:

- Të gjitha shkollat profesionale duhet të jenë të pajisura me Website,
- Sistem të integruar informimi të të rinjve përmes përdorimit të metodave të ndryshme,
- Në çdo shkollë të themelohet një lloj Grupi i Promovimit, i përbërë nga drejtues të shkollës, mësues, përfaqësues aktiv nga biznesi, përfaqësues nga DKA-të, përfaqësues nga pushteti lokal dhe përfaqësuesit e nxënësve,
- Dokument me sqarime dhe veçori për të gjitha drejtimet, profilet që ofrohen nga shkolla duke përshkruar karakteristikat e veçoritë e këtyre profileve. Dokumenti, duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshme për të gjitha moshat,
- Me përmbajtjet kryesore promovuese të hartohen edhe publikime të tjera në formën e fletëpalosjeve, broshurave, posterave, etj.,
- Duke njohur rolin e mediave në vetëdijesimin dhe informimin e njerëzve, në nivel lokal të shfrytëzohet hapësirë në medie lokale për promovim të shkollave të mesme profesionale dhe të prezantohen tregime suksesi të nxënësve nga këto shkolla,
- Duke pasur parasysh moshën e nxënësve që kanë mundësi për t'u regjistruar në shkolla të mesme profesionale, është e nevojshme promovimi i shkollave dhe drejtimeve po ashtu në rrjetet sociale. Kjo do të mund të arrihej duke krijuar faqe në rrjetet sociale si Facebook, Twitter, Instagram dhe LinkedIn lidhur me profilet dhe drejtimet e ofruara nga shkollat e mesme profesionale,
- Realizimi i sesioneve informuese nëpër shkollat fillore, zonat e frekuentuara të qytetit si dhe fshatrave përreth,
- Organizimi i mbrëmjeve të ndryshme jo-formale sikurse debatuese,
- Shfaqja e filmave dhe dokumentarëve motivues për nxënësit.

THEMELIMI I QENDRAVE PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Iniciativa për themelimin e Qendrës për Orientim në Karrierë duhet të merret nga komunat sipas procedurave të parapara me statutin e komunës. Me vendim të komunës përkatëse të themelohet grupi që do të hartoj statutin e Qendrës. Statuti do të definojë funksionimin e përgjithshëm të Qendrës për Orientim në Karrierë.

Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësisë të tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë,

ruajtjes së ambientit si dhe krijimit të kushteve për të mundësuar gjetjen e vendeve të punës për të diplomuarit dhe praktikës adekuate profesionale për nxënës dhe avancimet e mëtutjeshme në karrierë.

Qendra për Orientim në karrierë duhet të mbështetet mbi legjislacionin në fuqi që parasheh përkrahjen e institucionet private në planifikimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur në bazë të nevojave të tyre², të bazuarit e arsimit mbi nevojat e tashme dhe të ardhshme të ekonomisë dhe mbështetja e zhvillimit të karrierës si pjesë e integruar e procesit të mësuarit gjatë gjithë jetës³.

Pra, si bazë ligjore për themelimin e Qendrave për Orientim në Karrierë, Komunitat mund t'u referohen Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (neni 6.3.3.) dhe Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional për të Rritur (neni 9).

Mbi këto obligime ligjore të MASHT dhe komunave, por duke pasur për bazë targetin që kanë Qendrat dhe kompetencat të cilat dalin nga legjislacioni në fuqi, iniciativa për themelimin e Qendrës për Orientim në Karrierë duhet të merret nga komunitat sipas procedurave të parapara me statutin e komunës. Me vendim të komunës përkatëse të themelohet grupi që do të hartoj statutin e Qendrës. Statuti do të definoj funksionimin e Qendrës. Në grupin përgjegjës për hartimin e statutit të qendrave do të jenë: përfaqësuesit të DKA-së, shkollave profesionale, këshillit të nxënësve dhe e mbikëqyrur nga MASHT.

MUNDËSITË POTENCIALE TË FINANCIIMIT

Funksionimi i mirëfilltë i Qendrave për Orientim në Karrierë varet shumë edhe nga mundësitë financiare të cilat Qendra i posedon për të operuar. Ndonëse nuk janë shumë të kushtueshme, të gjitha aktivitetet që Qendrat për Orientim në Karrierë zakonisht i organizojnë, megjithatë ato duhet paraprakisht të planifikohen, e edhe të buxhetohen në mënyrë që të mund të realizohen në praktikë. Shumëllojshmëria dhe numri i aktiviteteve që këto qendra do të mund të realizonin, varen direkt nga buxheti me të cilin operon Qendra. Përveç tjerash, Qendra duhet të punësoj së paku dy punonjës, të cilët do të përkujdeseshin për punën ditore të Qendrës si dhe organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të ndryshme të Qendrës.

Duke pasur parasysh këta faktorë, stabiliteti financiar i Qendrave për Orientim në Karrierë është shumë i rëndësishëm, ku në njëfarë mënyre përcakton edhe suksesin e punës së Qendrës.

² LIGJI NR. 04/L-143 PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PËR TË RRRITUR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS. Shih: <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2868> (qasur më 13.11.2016)

³ LIGJI Nr. 04/L-138 PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL. Shih: <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8676> (qasur më 13.11.2016)

Disa nga shpenzimet kryesore të cilat një Qendër për Orientim në Karrierë mund të përballet janë:

- Pagesat mujore për stafin e angazhuar,
- Shpenzimet mbi objektin që shfrytëzohet dhe të gjitha shpenzimet përcjellëse, nëse aplikohen,
- Shpenzimet për dizajnimin e broshurave, posterëve dhe materialeve tjera promovuese,
- Printimi i broshurave, posterëve dhe materialeve tjera promovuese,
- Pagesat për ekspertët e angazhuar për hulumtime specifike etj.

Fakti që veç është i ditur dhe aplikohet në të gjitha vendet ku këto lloj qendrash operojnë është se asnjë prej qendrave të karrierës nuk aplikojnë pagesa për shërbimet të cilat i ofrojnë; andaj, nuk krijojnë të ardhura prej aktiviteteve të tyre. Shpenzimet e funksionimit të Qendrave për Orientim në Karrierë mbulohen kryesisht prej buxhetit shtetëror. Përveç alokimit të fondeve nga buxheti i Komunës, në disa raste Qendrat mund të financohen edhe përmes formave të tjera.

Duke marrë parasysh format e financimit të Qendrave për Orientim në Karrierë në vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, format kryesore për financimin e QOK-ve janë:

- Përmes buxhetit të shtetit, ku Komuna parasheh dhe ndanë buxhet për Qendrën,
- Përmes donacioneve – Qendra mund të financohet përmes marrjes së donacioneve nga organizata vendore e ndërkombëtare, fondacione të ndryshme apo grupe të interesit,
- Përmes granteve – duke i dhënë statusin e Personit Juridik përmes Statutit të Themelimit, Qendra mund të aplikoj për të përfituar grante nga donatorë të ndryshëm, duke aplikuar me projekte konkrete.

INICIATIVA PËR PROGRES – INPO

INPO është themeluar në vitin 2005 duke implementuar aktivitete që kanë ndihmuar integrimin e qytetarëve në proceset sociale dhe vendimmarrëse. Pas tri vite punë efektive, duke e parë të rëndësishme profilizimin e INPO-s, kemi përcaktuar fushën e politikave publike, si qëllimin bazë të punës së organizatës.

Gjatë këtyre njëmbëdhjetë viteve të punës intensive ne kemi ndërtuar raport të shkëlqyeshëm me mediat si dhe partneritet me organizata të ndryshme, duke qenë anëtar të disa rrjeteve të rëndësishme në Kosovë. Stafi i INPO-s është rritur, duke mundësuar kështu edhe rritjen e zonave të monitorimit, në më shumë komuna të Kosovës dhe duke zgjeruar programet e veprimit. Synimi që të jemi pjesë e rrjeteve rajonale është arritur dhe INPO do të vazhdojë të përmbush këtë qëllim, gjithmonë duke ruajtur raportet e mira me partnerët aktual.

Avokimi dhe fushatat sensibilizuese në fushën e politikave publike, përbëjnë aspektin më të suksesshëm të punës së organizatës gjatë këtyre njëmbëdhjetë viteve. Ne synojmë të jemi një partner konstruktiv në të gjitha proceset në kuadër të fushës sonë të veprimitarisë.

Vizioni i Organizatës INPO është për *institucione lokale që qeverisen me vlera demokratike ku qytetari është bashkëvendimmarrës*, ndërsa INPO për mision të saj ka *promovimin e demokratizimit të qeverisjes lokale përmes aktivizmit qytetar dhe përkushtohet në avansimin e vlerave të një shoqërie të hapur*.

Organizata INPO funksion me dy programe:

- I. Programi për Qeverisje të Mirë - që ka për qëllim promovimin e qeverisjes së përgjegjshme duke nxitur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit,
- II. Programi për Edukim Demokratik - që ka për qëllim krijimin e mundësive për të rinjtë për të qenë aktiv dhe promotor të një shoqërie të hapur.